

RAPORTI I EKSPERTIT KONTABEL TE REGJISTRUAR

Mbi Pasqyrat Financiare te Kapitaleve te veta
te Shoqerise per qellim te zvoglimit te kapitalit
te regjistruar.

«HEC i Tervolit» Shpk

Per periudhen
Deri me 31 dhjetor 2022

RAPORTI I EKSPERTIT KONTABEL TE REGJISTRUAR

Mbi Pasqyren Financiare te
Kapitaleve te Veta te Shoqerise per qellim te zvoglimit te kapitalit te regjistruar:

«HEC I TERVOLIT» Shpk

Per periudhen deri me
31 Dhjetor 2022

Drejtuar: Julian Skraqi
Administrator

Komuna Pishaj, Tervol, Elbasan

Me vendimin e asamblese se ortakeve, me objekt zvoglimin e kapitalit te shoqerise, mu kerkua te ekspertoj vertetesine dhe rregullshmerine e shumave te kapitaleve te veta me qellim zvoglimin e kapitalit te regjistruar te shoqerise „HEC i Tervolit“ sh.p.k.
Ne kemi audituar „Pasqyren Financiare te Kapitaleve te Veta te Shoqerise per qellim te zvoglimit te kapitalit te regjistruar te shoqerise „HEC i Tervolit“ sh.p.k, (shoqeria), per periudhen deri me date 31 Dhjetor 2022.

Drejtimi i shoqerise eshte pergjegjes per pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te ketyre pasqyrave financiare, ne perputhje me standartet kombetare te kontabilitetit. Kjo pergjegjesi perfshin: hartimin, zbatimin, dhe mbajtjen e kontrollit te brendeshem te pershtatshem mbi pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te pasqyrave financiare, pa anomalit materiale te shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, zgjedhjen dhe zbatimin e metodave te pershtateshme kontabel, kryerjen e cmuarjeve kontabel te arsyeshme per rrethanat.

Pergjegjesia jone eshte te shprehim nje opinion mbi keto pasqyra financiare bazuar ne auditimin tone. Auditimi yne u be ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit. Keto standarte kerkojne qe ne te respektojme kerkesat e etikës dhe te planifikojme dhe te kryejme auditimin me qellim qe te marrim nje siguri te arsyeshme nese pasqyrat financiare nuk kane anomalit materiale.

Auditimi ka te beje me kryerjen e procedurave per te marre evidence auditimi rreth shumave dhe informacioneve te dhena ne pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, perfshire ketu edhe vleresimin e rreziqeve te anomalive materiale ne pasqyrat financiare si pasoje e mashtrimit apo gabimit. Kur vlereson keto rreziqe, audituesi merr ne konsiderate kontrollin e brendeshem te shoqerise mbi pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te pasqyrave financiare ne menyre qe te planifikojë procedura te pershtateshme auditimi ne rrethanat perkatese te shoqerise, por jo me qellim qe te shprehe nje opinion mbi efektivitetin e kontrollit te brendeshem te shoqerise. Auditimi gjithashtu ka te beje me vleresimin e pershtatshmerise se metodave kontabel te perdorura dhe arsyeshmerine e cmuarjeve kontabel te bera nga drejtimi, si dhe me vleresimin e paraqitjes se pergjitheshme te pasqyrave financiare.

Ne besojme se evidenca e auditimit qe ne kemi marre eshte e mjaftueshme dhe e pershtateshme per te dhene bazat e opinionit tone te auditimit.

**PASQYRA FINACIARE E KAPITALEVE TE VETA TE SHOQERISE
PER QELLIM TE ZVOGLIMIT TE KAPITALIT TE REGJISTRUAR
„HEC I TERVOLIT“ sh.p.k**

Per periudhen deri me 31 Dhjetor 2022

Kapitalet e veta	31 Dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Kapitali i regjistruar	390,929,905	390,929,905
Rezervat		
Rezerva ligjore		
Rezerva statutore		
Rezerva te tjera		
Fitime te mbartura	2,910	(124,278)
Fitime te ushtrimit	112,655,854	145,817,187
Kapit i regjistruar, rezervat, fitimet	503,588,669	536,622,814

LEVIZJA E KAPITALEVE TE VETA

Ndryshimet ne kapitalet e veta te shoqerise	Kapitali i regjistruar	Rezerva ligjore	Fitime te mbartura	Fitime te ushtrimit	Totali
Gjendja me 31.12.2022	390.929.905		2.910	112.655.854	503.588.669
Zvoglimi i kapitalit	-80.000.000	80.000.000			
Dividente te paguar					
Gjendja pas zvoglimit te kapitalit	310.929.905	80.000.000	2.910	112.655.854	503.588.669

Llogaritjet per zvoglimin e kapitalit	Shuma
Kapitali 31.12.2022 (para ndryshimeve)	390.929.905
Zvoglim kapitali	-80.000.000
Kapitali pas zvoglimit	310.929.905
Fitimet e pashperndara pas zvoglimit te kapitalit	
Numuri i kuotave pas zvoglimit	5
Nje kuote zoterohet nga ortaku “Ble-Klo-Ar” shpk me 38.43%	119.490.362
Nje kuote zoterohet nga ortaku “Skraqi” shpk me 34.2%	106.338.028
Nje kuote zoterohet nga ortaku Refat Mustafaraj me 14.5%	45.084.836
Nje kuote zoterohet nga ortaku Olset Haxhiu me 8.37%	26.024.833
Nje kuote zoterohet nga ortaku Bashkim Spahiu me 4.5%	13.991.846

Ne perfundim ne shprehim opinionin tone se pasqyra finaciare e kapitaleve te veta per qellim te zvoglimit te kapitalit te regjistruar te shoqerise, jep nje paqyrim real dhe te vertete te bilancave te shoqerise per periudhen deri me 31 Dhjetor 2022. Shuma e kapitaleve te veta, jane ne perputhje me dokumentat dhe regjistrimet kontabel te shoqerise.

Me respekt

Rubin Qenani

Ekspert Kontabel i Autorizuar

Licence nr 486

Elbasan, me 10.12.2023

Rubin

